



15-02-2018



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Nr./Br. 205-2018

Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe nenin 37.2 nën paragrafi (c dhe f) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 15.02.2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **Z. ISAH HODA** emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Kamenicë, nga subjekti politik “Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK” duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal **z. Enver Mavriqi**.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t’i komunikohet **z. Isah Hoda**, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 31.01.2018, nr.151/2018, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit z.Enver Mavriqi, pas dorëheqjes së tij të parëvokueshme nga pozita e anëtarit të Kuvendit të Komunës, për arsye të emërimit në pozitën e nënkryetarit të komunës.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatit të radhës sipas listës së rirenditur, i cili është z.Isah Hoda, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 15.02.2018

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

  
Valdete Daka